RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0094/22
Data 17.05.2022
PRISHTINË

Në bazë të nenit 29 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, të nenit 17 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës,në mbledhjen e mbajtur më datë 17.05.2022, merr:

VENDIM

1. Për plotësim/ndryshimin e Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës.Ndryshohet pika 1 e nenit 19, pika 2 e nenit 22 dhe shtohet pika 29e nenit 36 të Statutit të RTK-së, aty ku thuhet:

Neni 19, pika 1
- Drejtorin e përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi i RTK-së në bazë të Ligjit e sipas procedurave të parapara me konkurs publik.

Plotësim ndryshimi duhet të jetë:

- Drejtorin e përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi i RTK-së në bazë të Ligjit dhe Rregullores për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së.

Neni 22, pika 2
- Zëvendësdrejtorët, Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhen shqipe, Drejtorin e RTK-Radios dhe Udhëheqësin e Shërbimeve te Përbashkëta, i zgjedh Bordi, duke marrë në konsiderim rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Plotësim ndryshimi duhet të jetë:

- Zëvendësdrejtorët,Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhën shqipe, Drejtorin e Kanalit Televiziv në gjuhen serbe,Drejtorin e RTK-Radios dhe Udhëheqësin e Shërbimeve të përbashkëta, i zgjedh Bordi sipas procedurave të parapara në Rregulloren për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të përgjithshëm dhe Menaxhmentit të lartë të RTK-së.

Si dhe nëNenin 36 shtohet pika 29:
- Rregullore për procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit tëpërgjithshëm dheMenaxhmentit të lartëtë RTK-së.

2. Ndryshimet t'i bashkëlidhënStatutit të Radiotelevizionit të Kosovës;

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Besnik Boletini
Kryetar i Bordit të RTK-së

Prishtinë
17 maj
2022

Vendimi iu dërgohet:
Anëtarëve të Bordit të RTK-së
u.d Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së
Sekretarisë së Bordit
Administratës së RTK-së
Arkivit